

URDHËR
Nr. 120, datë 24.6.2021

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE PËR MIRATIMIN, PUBLIKIMIN E
PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS DHE TË REGJISTRIT TË KËRKESAVE DHE
PËRGJIGJEVE TË RISHIKUAR**

Bazuar në nenin 22, pika 3, 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 177, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 19, pika 2, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1, të nenit 4, pikat 1 dhe 2, të nenit 5, pikat 1 dhe 2, të nenit 13, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, te Sekretari i Përgjithshëm, z. Emis Çërava, si nëpunësi më i lartë civil në KLP, sipas klasifikimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
2. Ngarkohet z. Emis Çërava për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
Gent Ibrahimi